

VENDIM
Nr.175, datë 19.2.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë shkollës së lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, me seli në Tiranë, të studimeve “Master i nivelit të parë” (MNP) në:

- a) Administrim biznesi,
- b) Financë,
- c) Kontabilitet.

2. Studimet në “Master i nivelit të parë” (MNP) synojnë arsimimin dhe trajnimin e mëtijshëm profesional. Këto programe studimi do të realizohen me së paku 60 kredite, me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma “Master i nivelit të parë” (MNP), përkatësisht në:

- a) Administrim biznesi,
- b) Financë,
- c) Kontabilitet.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha